



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 925	
	19. 11. 2021	
	PRISHTINË - A	

KGJK.nr.346/2021

Datë: 15 nëntor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Driton Muharremi, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/08/2021/GJA-AGJ.nr.625/2021, të datës 12 tetor 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 15 nëntor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Driton Muharremi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 5, paragrafi 2, pika 2.9 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Për këtë shkelje disiplinore gjyqtarit Driton Muharremi i shqiptohet sanksioni disiplinor Transferim i përhershëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 10 gusht 2021 ka pranuar kërkesë nga Autoriteti Kompetent me pretendim se z. Driton Muharremi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 5 paragrafi 2, pika 2.9 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përmes së cilës ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor, me ç'rast ka propozuar që ndaj të njëjtit në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore nga gjyqtari Muharremi, t'i shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara në dispozitën e nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, kërkesës së lartcekur i ka bashkangjitur edhe incizimet e bisedave telefonike të publikuara më datë 4 gusht 2021, në gazeta dhe portale të vendit, në bazë të të cilave incizime është i përfshirë edhe gjyqtari Muharremi, me ç'rast ka kërkuar iniciimin e hetimit disiplinor.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.222/2021, të datës 13 gusht 2021, ka themeluar Paneli Hetimor për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/08/2021/GJA-AGJ.nr.625/2021, të datës 12.10.2021, i cili panel i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Këshilli me datë 8 dhe 15 nëntor 2021, ka mbajtur seanca dëgjimore, pas pranimit të Raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, ku kanë marrë pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtari Avni Syla dhe avokati Artan Qerkini, i autorizuar nga subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Driton Muharremi.

Kryesuesi i Panelit Hetimor në seancën dëgjimor, bazuar në Ligjin Nr.06/l-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me datë 29.09.2021, në të cilën është ftuar subjekti i hetimit disiplinor.

Paneli Hetimor ka marrë vendim që ti drejtohet Prokurorisë Themelore në Prishtinë me kërkesë për informacion se a është ndërmarr ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje. Nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Paneli Hetimor ka pranuar përgjigje me datë 15.09.2021, më të cilën është njoftuar se lidhur me rastin e përgjimeve të publikuara në portalin shqip.com, me datë 30.08.2021, prokuroria ka lëshuar autorizim për grumbullimin e informatave, nën shenjen RRNI.nr.385/2021, në drejtim të veprës penale Përgjim i paautorizuar nga neni 201 i KPRK.

Faktet e gjetura të Panelit Hetimor ianë se subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Muharremi, ka biseduar në telefon me personin _____ në të cilën bisedë personi _____ i ka kërkuar subjektit të hetimit që të bisedoj me Kryeprokurorin e _____ lidhur me një veturë të konfiskuar, me ç'rast subjekti i hetimit i ka premtuar personit _____ se do të kontaktoj Kryeprokurorin e Shtetit lidhur me çështjen e veturës së konfiskuar. Subjekti i hetimit në seancë ka pranuar se ka biseduar në telefon me personin _____.

Paneli Hetimor, ka konstatuar se nuk kanë pasur informacion se subjekti i hetimit ka kontaktuar Kryeprokurorin _____ për të ndikuar në lirimin e veturës së konfiskuar. Nga incizimet sipas vlerësimit të Panelit Hetimor nuk ka informacion se gjyqtari Driton Muharremi ka kërkuar diçka për këtë çështje, dhe që bashkëbiseduesi _____ ti ketë ofruar shpërblim subjektit të hetimit gjyqtarit Driton Muharremi.

Paneli Hetimor bazuar në faktet dhe provat e mbledhura ka arritur në përfundim së publikimi i këtyre incizimeve të bisedave telefonike dhe publikimi nëpër portale dhe gazeta ka ndikuar në uljen e reputacionit dhe besueshmërinë e qytetarëve ndaj gjyqësorit.

Paneli Hetimor, raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura i'a ka bashkangjitur edhe provat materiale si: transkriptet e bisedave që janë bërë në mes subjektit të hetimit dhe personit anonim se bashku me materialet e botuara në gazetën Shqip.com; CD-ja, që përmban biseda të publikuara në gazetën shqip.com; Shkresa e ushtruesit të detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit për inicimin e procedurës disiplinore të datës 10.08.2021; Shkresa e drejtuar KGJK-së, për dorëheqje nga gjyqtari Driton Muharremi të datës 6.08.2021; Kërkesën me shkrim të datës 14.09.2021 drejtuar Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë _____, në lidhje me marrjen e informatave se a është iniciuar ndonjë procedurë hetimore në lidhje me rastin e përgjimeve; Përgjigjen me shkrim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë të datës 15.09.2021 dhe deklaratën e gjyqtarit Driton Muharremi e dhënë në seancën dëgjimore me datë 29.09.2021 me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesën e iniciuar nga organi kompetent.

Paneli Hetimor gjithashtu si pjesë të raportit ka sjell edhe një pjesë të deklaratës se gjyqtarit Driton Muharremi, audio incizimi dhe transkripti i audio incizimit që gjendet në shkresat e lëndës disiplinore.

Avokati i subjektit të këtij hetimi disiplinor z. Artan Qerkini, në seancën dëgjimore të KGJK-së të mbajtur me datë 8 dhe 15 nëntor 2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratimeve të dhëna nga gjyqtari Driton Muharremi në këtë procedurë disiplinore të dhëna pranë Panelit Hetimor, duke shtuar se bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk do të vërtetohet se z. Muharremi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Me tutje, ka theksuar se provat në të cilat është mbështetur inicim i procedurës disiplinore nga ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit, në shkrimet e publikuara në portale dhe gazeta me datë 4 dhe 6 gusht 2021 nuk përkojnë me përmbajtjen e incizimit i cili është pjesë e kësaj dosje disiplinore. Sepse nëse e dëgjojmë incizimin ne nuk do ta shohim se z. Muharremi ti ketë thënë bashkëbiseduesit të tij se “Çka ke te fol me mu”. Po ashtu, avokatit Qerkini, ka thënë se përmbajtja e bisedës e cila është objekt shqyrtimi, dëshmon se z. Muharremi nuk e ka cenuar besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, sepse gjatë kësaj bisede ai nuk premtonte asgjë të kundërligjshme, prandaj është shumë i rëndësishëm fakti se në momentin kur është zhvilluar kjo bisedë personi në fjalë nuk ka qenë i pandehur, i dyshuar, apo së paku z. Muharremi nuk ka qenë në dijeni se një person i tillë mund të ketë pas një precedent kriminal, por është zhvilluar një bisedë me një person i cili ka pretenduar se është viktimë e sistemit të drejtësisë. Më tutje, avokati Qerkini ka deklaruar se asnjë provë e vetme nuk thotë që z. Muharremi të ketë ndërhyrë, në mënyrë të kundërligjshme, ngase dispozita e nenit 5, paragrafi 2.2.9, konsideron shkelje nga ana e gjyqtarit nëse ai ndërhyrë tek një gjyqtar apo prokurorë.

Këshilli në seancën dëgjimore të mbajtur më 8 nëntor 2021, ka miratuar propozimin e avokatit të subjektit të hetimit që në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohet . Në seancën e datës 15 nëntor 2021, dëshmitari ka deklaruar se është në dijeni të përmbajtjes së bisedës ndërsa gjyqtari subjekt i hetimit nuk ka kërkuar nga i njëjti asnjë favor, pasi që më aq sa është në dijeni dëshmitari ndaj personit nuk ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale.

Për ta vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore Këshilli administroj dhe vlerësoj këto prova: Kopjen e lajmit në Shqip.com, të publikuar me datë 4 gusht 2021, ora 9.59, me titull “ Çka ke me fol me mu”; Lajmin e publikuar në shqip.com, që është vazhdimin – titulli ekskluzive, shantazh, pastrim figurash, emërime nëpër poste; Publikimi në shqip.com, titulli flet Kryeprokurori , bashkë me vazhdimin; Emali i gjyqtarit Driton Muharremi për dorëheqjen si anëtar i Këshillit; Shkresa drejtuar Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, , datë 10.09.2021; informacioni nga Avni Syla, i datës 9.10.2021, email; Transkripti i nxjerr nga portalet shqip.online nga IT; Shkresa e datës 15.09.2021, A.nr.296/2021 nga Paneli hetimor për Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Shkresa e datë 14.09.2021; Kërkesë për informacion nga Kryeprokurori në këtë rast nga Kryesuesi i Panelit z.Avni Syla; Procesverbali i përpiluar me datë 10 shtator 2021; Transkripti nga seanca e Panelit Hetimor të mbajtur me datë 29 shtator 2021, ditë e mërkure.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli konstatoj se gjyqtari Driton Muharremi ishte përfshirë në bisedat e regjistruara telefonike me bashkëbiseduesin , biseda këto të publikuara në portalin shqip.com, me datë 4 gusht 2021, si dhe në gazeta dhe portale tjera. Gjatë regjistrimeve telefonike të publikuara në shqip.com është dëgjuar që gjyqtari Driton Muharremi ti ketë thënë bashkëbiseduesit citoj “çka ke me fol me mu”. Vet gjyqtari Driton Muharremi në seancën dëgjimore para Panelit Hetimor të mbajtur me datë 29 shtator 2021, ka pranuar se ka biseduar në telefon me personin

i cili kishte kërkuar nga i njëjti që të bisedoj me Kryeprokurorin lidhur me një veturë të konfiskuar.

Këshilli në bazë të provave të administruara ka gjetur se gjyqtari Muharremi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduara nga autoriteti kompetent pasi që komunikimi i tij me personin kualifikohet si shkelje nga neni 5 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Po ashtu, Këshilli ka vlerësuar se komunikimi i gjyqtarit me personin dhe pastaj me dëshmitarin e dëgjuar në këtë çështje disiplinore i konsumon të gjitha elementet e shkeljes disiplinore për të cilën është shqiptuar masa disiplinore.

Me dispozitën e nenit 2, paragrafi 2.1, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, përcaktohet se: “gjyqtari me sjelljen e tij në gjykatë dhe jashtë gjykatës ruan dhe avancoon besimin e publikut dhe palëve në paanshmërinë e tij dhe gjyqësorit në përgjithësi”, ndërsa në nenin 4 paragrafi 4.1, përcaktohet se: “gjyqtari si bartës i funksionit të rëndësishëm publik dhe që i nënshtrohet vazhdimisht mbikëqyrjes nga publiku, sipas vullnetit të lirë pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron”.

Përveç kësaj, në dispozitën e nenit 4 paragrafi 4.5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, përcaktohet se: “gjyqtari nuk do të lejojë që relacionet e tij familjare, shoqërore apo tjera të ndikojnë në mënyrë të pandinjitetshme në ushtrimin e funksionit të tij”. Ndërsa në paragrafi 4.6 përcaktohet se: “gjyqtari në asnjë rrethanë nuk do të shfrytëzojë pozitën e tij gjyqësore as t’i lejojë të tjerët që ta shfrytëzojnë pozitën e tij për interesa private”.

Nga përmbajtja e dispozitave të cituara të Kodit të etikës, rrjedhin qartë përgjegjësitë e gjyqtarit që gjatë tërë kohës sjelljet e gjyqtarit duhet të promovoj besimin e publikut në gjyqësor, duhet të ruhet dhe promovohet integriteti i figurës së gjyqtarit dhe rrjedhimisht duhet shmangur çfarëdo influencimi i interesave apo rrethit shoqëror në funksionin e gjyqtarit, andaj në rastin konkret vlerësohet se sjellja e gjyqtarit i ka konsumuar të gjitha elementet e shkeljeve etike, me ç’rast është ndikuar drejtpërdrejtë në reputacionin e figurës së gjyqtarit, imazhin e gjyqësorit dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Fakti se bisedat e gjyqtarit janë bërë publike përmes një portali kanë ndikuar që mosbesimi i publikut në gjyqësor të rritet.

Përveç dispozitave të sipër theksuara të kodit të etikës, kualifikimi i shkeljes disiplinore të gjyqtarit bëhet në përputhje me nenin 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 5, paragrafi 2, pika 2.9 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Me dispozitën e nenit 2 pika 2.9 përcaktohet “ndërrhyja në veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë me qëllim të ndikimit në aktivitetet dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj”, ndërsa me dispozitën e nenit 2.15 përcaktohet se “përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit”.

Këshilli ka vlerësuar se sjellja e gjyqtarit Muharremi, përbën shkelje nga neni 2 pika 2.9 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sepse veprimet e tij cilësohen si ndërhyrje në veprimet e prokurorit me qëllim ndërhyrje dhe rrjedhimisht edhe shkelje nga neni 2 pika 2.15, sepse me veprimet e tij e ka dëmtuar reputacionin e gjykatës dhe ka dëmtuar besimin e publikut në besueshmërinë e gjyqësorit.

Me veprimet e gjyqtarit Muharremi, sidomos pas publikimit të përgjimeve është dëmtuara rënd reputacioni i figurës së gjyqtarit dhe gjithashtu është dëmtuara rënd imazhi i sistemit gjyqësor, i cili ndërtohet dhe promovohet mbi principet e pavarësisë, paanësisë, integritetit, profesionalizimit dhe përgjegjësie. Veprimet e gjyqtarit Muharremi, i kanë cenuara parimet bazë të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe përgjegjësisë që ka gjyqësori për të promovuar vlerat e trajtimit të barabartë

të qytetarëve para ligjit dhe para gjykatës si dhe vlerat që publiku të besoj në drejtësi të paanshëm e cila i reziston çfarëdo ndërhyrje.

Gjyqtari duhet të sillet me pavarësi, duke shmangur çfarëdo përpjek të subjekteve të interesit që të influencojnë procedurat gjyqësore, dhe jo vet gjyqtari të cenoj pavarësinë dhe paanshësinë me veprime të tilla që shfaqen si përpjekje për të influencuar procedurat para institucioneve të drejtësisë.


Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor i cili është vlerësuar si raport i besueshëm pasi që në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore Paneli ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, përfaqësuesit të tij dhe deklaratën e dëshmitarit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër.

Masa disiplinore e shqiptuar sipas vlerësimit të Këshillit është masë proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit duke siguruar kështu zbatimin e përgjegjësisë ligjore që ka Këshilli Gjyqësor në procedurën e disiplinimit të gjyqtarëve sipas Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Masa disiplinore sipas Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duhet të jetë masa e cila ndikon tek gjyqtari subjekt i hetimit që të korrektoj veprimet e tij/saj, gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4, dhe paragrafi 2, pika 2.2, të Ligjit nr.06/l-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.346/2021, datë: 15 nëntor 2021

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Afrim Shala, U.d. Kryetar, Gjykata e Apelit;
- Driton Muharremi, Gjyqtar, Gjykata e Apelit;
- Arkivit.